



PSH.nr.149/21
155/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik N.T.G “Blendi”-Prishtinë dhe OE N.T “Agimi-De” & “Hajrije Selmanaj B.I”-Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.SH “Erpo Peint” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material të shtypur” me nr. të prokurimit 632-20-5688-1-l-l, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë”, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik N.T.G “Blendi”-Prishtinë dhe OE N.T “Agimi-De” & “Hajrije Selmanaj B.I”-Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material të shtypur” me nr. të prokurimit: 632-20-5688-1-l-l, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material të shtypur” me nr. të prokurimit: 632-20-5688-1-l-l, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë”, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues N.T.G “Blendi”-Prishtinë dhe OE N.T “Agimi-De” & “Hajrije Selmanaj B.I”-Deçan, aprovohen si të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues N.T.G “Blendi”-Prishtinë dhe OE N.T “Agimi-De” & “Hajrije Selmanaj B.I”-Deçan, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 16.02.2021 me nr. 149/21, dhe me datë 18.02/2021 me nr. 155/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të shtypur” me nr. të prokurimit: 632-20-5688-1-I-I, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60 dhe neni 61 par.1 lidhur me nenin 3.1 dhe 3.2, 4.4 të LPP-së, te ankesa me nr. 149/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe nenin 61 të LPP-së, te ankesa me nr. 155/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës: 01.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.T.G “Blendi”-Prishtinë

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Operatori ekonomik ankues N.T.G “BLENDI”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.SH “ERPO PRINT” SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Konkretisht për pozicionet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 36, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 46, 47, 48, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 61, 62, 64, 67, 69, 70, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, ka ofruar çmim ab normalisht të ulët. Autoriteti kontraktues me dt:29.01.2021, përmes Letrës standarde kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, i drejtohet sqarime për pozicionet që shihen më poshtë, dëshmitë shih më poshtë:



Letër Standarde e Kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët

29.01.2020, Gjakovë

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit)

NDËRMARRJA SHËRBYESE TREGTARE „ERPO-PRINT“ SH.P.K., TIRANA
P.N., 50000, GJAKOVË

Nr. i Prokurimit	632	2	0	5	6	8	8	1	1	1
Nr. i brendshëm	632	2	0	0	9	1	1	1	1	1

Titulli: Furnizim me material të shtypur

Inderuar Z. Erzen Pozhari

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushtieve dhe kriterëve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund të vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Në dosjen e tenderit tuaj të paraqitur kemi vërejtur se çmimi i paraqitura në disa pozicione janë ca të ulëta, në pozicionet e cekura si më poshtë:

pozicioni

1,2,4,5,9,10,14,19,24,25,28,30,31,37,42,46,47,50,53,54,55,56,61,62,67,81,82,83,84,88,92,97,99,101,102,104 dhe 108 kërkohej arsyeshmëri dhe zbërthim i çmimeve të ofertuara për këto pozicione.

Informatat e kërkuara duhet të pranohen **me shkrim**, në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues, në e-mail faton.gutaj@rka-gov.net brenda 5 ditëve nga data e kësaj kërkesë (deri më dt. 03.02.2020 në ora 16:00).

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Ju faleminderit për përpjekjet.

Me respekt,


Faton Gutaj
Kryetar i Komitetit të Prokurimit

Operatori ekonomik NTSH "EURPO PRINT" SHPK, me dt:02.02.2021, i përgjigjet AK-së, shih përgjigjen e prezantuar më poshtë, dhe së bashku me përgjigje si dëshmi i ka ofruar disa foto, të stoqeve që i ka në depo.

Shtypshkronja - Printing House
ERPOPRINT

Adresa: 044 300 000
Telefon: 044 330 000
Adresa: Rr. "St. Tereza" p.k.,
Gjakovë - Kosova
e-mail: erpoprint@erpoprint.com, erpoprint@yohim.com
Nr. i Shënësuar: 02112202
Nr. i TVSH: 330040008
Nr. Pukot: 600163800
Banka Ekonomike: 1402000001401003
ProCredit Bank: 1140134678000106

Për:	Komuna e Gjakovës Zyra e Prokurimit - Z. Faton Gutaj
Subjekti:	Sqarim
Nga:	N.S.H.T. "ERPO-PRINT" sh.p.k.
Data:	02/02/2020
Titulli i Kontratës:	Furnizim dhe material të shtypur për nevojat e Komandës së Gjakovës Nr. prokurimit: 632-20-5688-1-1-1 Nr. brendshëm: 632-20-091-111

Sa i përket Letër Standarte e Kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ne pas shikës së tuaj kemi analizuar dhe njëllojë çmimet e pozicioneve të cilat ju konsideroni si çmime jo-normalisht të ulëta dhe pas analizës së çmimeve ne konstatojmë se të gjitha çmimet për pozicionet e cekura i kemi analizuar mirë dhe ne formë të detajuar sepse ne posedojmë një sasi shumë të madhe të mallit në stok dhe në kushte jo të favorshme të qëndrimit të mallit në afat të gjatë (në rrethim të largët) bashkëgjatë fotot për mallin që e posedojmë.

Gjithashtu njëra prej arsyeve pse ne kemi ofertuar me këto çmime është se kompania jonë ka një numër të konsiderueshëm të stafit të nevojshëm për kryerjen e furnizimeve dhe shërbimeve.

Duke u bazuar në të gjitha këto që thamë më lartë ne si Operator Ekonomik garantojmë realizimin e kontratës në përpikëri të plotë.

Vlen të përmendet se oferta jonë është konform ligjit të LPP-së, si e përgjigjshme me çmimin më të ulët.

Me respekt

N.S.H.T. "ERPO-PRINT" sh.p.k.


N.S.H.T. "ERPO-PRINT" sh.p.k.

Autoriteti kontraktues e ka pranuar përgjigjen e OE “ERPO PRINT”, dhe të njëjtin e ka rekomanduar për dhënie të kontratës.

Eksperti shqyrtues sqaron duke u bazuar në tabelën e rregullores për çmime jo normalisht të ulëta, çmimi i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “EURPO PRINT” SHPK, e plotëson kushtin si tender me çmim jo normalisht i ulët.

Në nenin 61 paragraf 3 thuhet: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Në paragrafin 4.6 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, thuhet: Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit.

Andaj duke pasur parasysh nenin 4.6 të Rregullat për Tender jo –Normalisht të Ulët si dhe 61 të LPP-së, mendoj se është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së, se pas sqarimeve të marruara në lidhje me tenderët jo normalisht të ulët, AK-së të vendos që një tender ta trajtoj me tenderët tjerë.

Gjithashtu duke u bazuar në procedurat e ndjekura, autoriteti kontraktues ju ka përmbajtur dispozitave ligjore, ku ka kërkuar sqarime shitesë për çmimet e ofruara nga OE, dhe AK-ja konform sqarimeve e ka rekomanduar OE në fjalë për dhënie të kontratës, andaj të mbetet në përgjegjësin e AK-së, se si është bindur që me çmimin e ofruar OE mund të realizoj një kontratë që mund të dal nga ky aktivitet i prokurimit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Operatori ekonomik ankues N.T.G “BLENDI”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “ERPO PRINT” SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike.

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
--	-----	---

Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “ERPO PRINT” SHPK, nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, edhe pse mendoj se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon. Po ashtu në Vendimin PSH.nr.1049-1057/20, të dt:28.12.2020, thuhet:

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshimuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a) Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
--	-----	---

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, nga ana e ekspertit shqyrtues është vetëtuar se nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, mirëpo paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon dhe është me rëndësi që OE-te të plotësojnë specifikacionet teknike ashtu siç AK ka kërkuar, nëse ka kërkuar, kjo mund të konsiderohet një devijim i vogël sepse mungesa e dokumentit të lartcekur nuk ndryshon asgjë në kushtin material të tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.T "Agimi-De"&"Hajrije Selmanaj B.I"-Deçan

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Operatori ekonomik ankues N.T. "AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Operatori ekonomik i ka ofruar si dëshmi disa pozicione të cilat janë të prezantuara në ankesë, ku pretendon se në ato pozicione ka ofruar çmim abnormalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues sqaron duke u bazuar në tabelën e rregullores për çmime jo normalisht të ulëta, çmimi i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, e plotëson kushtin si tender me çmim jo normalisht i ulët.

Në nenin 61 paragraf 3 thuhet:

Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

Në paragrafin 4.6 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, thuhet:

Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: 4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtojë tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose 4.6.2

Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit. Andaj duke pasur parasysh nenin 4.6 të Rregullat për Tender jo – Normalisht të Ulët si dhe 61 të LPP-së, mendoj se është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së, se pas sqarimeve të marruara në lidhje me tenderët jo normalisht të ulët, AK-së të vendos që një tender ta trajtoj me tenderët tjerë. Gjithashtu duke u bazuar në procedurat e ndjekura, autoriteti kontraktues ju ka përmbajtur dispozitave ligjore, ku ka kërkuar sqarime shtesë për çmimet e ofruara nga OE, dhe AK-ja konform sqarimeve e ka rekomanduar OE në fjalë për dhënie të kontratës, andaj të mbetet në përgjegjësin e AK-së, se si është bindur që me çmimin e ofruar OE mund të realizoj një kontratë që mund të dal nga ky aktivitet i prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01.03.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 01.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik N.T.G "Blendi"-Prishtinë me datë 03.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

TE NDERUAR,

Ne lidhje me lenden ; 149 -155/21 eksp ne NTG BLENDI nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. dhe se nuk e di se ku po bazohet eksperti me kete mendim te tije duke e ditur qe NSHT ERPO PRINT ka 80% te qmimeve abnormalisht te ulta me kete po i hape rruge operatorve tjere qe te ofertojne me qmime ab normalisht te ulta dhe te marrin perbaze kete vendim . faleminderit. ntg blendi.

Operatori ekonomik N.T "Agimi-De"&"Hajrije Selmanaj B.I"-Deçan me datë 04.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përsëendetje, NT AGIMI ka pranuar raportin e ekspertit dhe nuk pajtohet me këtë raport pasi që në asnjë pikë tonën ankimore nuk është lëshuar. Vlen të theksohet se OE është abnormalisht me qmime më të ulta dhe manipuluese në 80% të qmimeve të ofruara janë qmime manipuluese dhe vlen të theksohet vetë disa prej artikujve me nr. rendor 88 Billbord në ofertën e OE e gjeni me çmim 0.01 cent artikulli me nr. rendor 14

Reklamë 3D me çmim prej 0.10 për metër katror , e që janë dëshmi e plotë se ky OE është me çmime manipuluese dhe jo normalisht të ulëta. Gjitha të mirat agimi De.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.G “Blendi”-Prishtinë, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.SH “ERPO PRINT” SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulëta dhe se çmimet e ofruara në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët , si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Konkretisht për pozicionet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 22, 23 ,24 ,25, 36, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 46, 47, 48, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 61, 62, 64, 67, 69, 70, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, ka ofruar çmim abnormalisht të ulëta.

Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me dt. 29.01.2021, përmes Letrës standarde kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, i drejtohet me kërkesë për sqarime për pozicionet të cilat AK i ka konsideruar me çmime jo-normalisht të ulëta, duke kërkuar sqarime për çmimet e ofruara në pozicionet si në letrën standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët. Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, me datë 02.02.2021 OE i rekomanduar N.TSH “EURPO PRINT” SHPK i përgjigjet AK-së me arsyetimin se posedon sasi të madhe të këtyre pozicioneve në stok dhe për shkak të mundësisë së lagështirës dhe prishjes ka ofruar me këto çmime, duke i bashkangjitur edhe fotografitë e stokeve të cilat OE i rekomanduar i posedon. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të OE ankues dhe përgjigjes së OE të rekomanduar për kontratë për autoritetin kontraktues, Paneli Shqyrtues vlerëson se arsyetimi i OE të rekomanduar është i pa arsyeshëm sepse rreth 80% e pozicioneve të OE të rekomanduar janë me çmime jo normalisht të ulëta dhe arsyetimi i tillë se kanë stoke të tepërta është i pa bazuar. Paneli Shqyrtues do ta merrte në konsideratë nëse OE i rekomanduar të kishte një numër të vogël të pozicioneve në stoke, por të ketë mbi 100 pozicione të ndryshme nuk është arsyetim bindës ashtu siç parashihet në rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se par. 4.2 i nenit 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, ka përcaktuar se:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Dispozita e cekur më lartë, ka përcaktuar se jo vetëm tenderi por nëse edhe një pozicion i tenderit duhet të jetë jo normalisht i ulët, AK dduhet të kërkoj nga OE një deklaram me shkrim. Në rastin konkret, AK ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar por është e pamundur që në shumicën e pozicioneve të ofroj çmime jo normalisht të ulëta dhe të zbatoj kontratën. Andaj, pretendimi i OE është i bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike.

Paneli Shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
--	-----	--

Paneli Shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, edhe pse vlerëson se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon. Po ashtu në Vendimin PSH.nr.1049-1057/20, të dt:28.12.2020, thuhet:

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
--	-----	--

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, nga ana e ekspertit shqyrtues është vetëtuar se nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, mirëpo paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon dhe është me rëndësi që OE-te të plotësoj specifikacionet teknike ashtu siç AK ka kërkuar, nëse ka kërkuar, kjo mund të konsiderohet një devijim i vogël sepse mungesa e dokumentit të lartëcekur nuk ndryshon asgjë në kushtin material të tenderit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.T "Agimi-De"&"Hajrije Selmanaj B.I"-Deçan

Operatori ekonomik ankues N.T. "AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "ERPO PRINT" SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Operatori ekonomik i ka ofruar si dëshmi disa pozicione të cilat janë të prezantuara në ankesë, ku pretendon se në ato pozicione ka ofruar çmim abnormalisht të ulët.

Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me dt. 29.01.2021, përmes Letrës standarde kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, i drejtohet me kërkesë për sqarime për pozicionet të cilat AK i ka konsideruar me çmime jo-normalisht të ulëta, duke kërkuar sqarime për çmimet e ofruara në pozicionet si në letrën standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët. Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, me datë 02.02.2021 OE i rekomanduar NTSH "EURPO PRINT" SHPK i përgjigjet AK-së me arsyetimin se posedon sasi të madhe të këtyre pozicioneve në stok dhe për shkak të mundësisë së lagështirës dhe prishjes ka ofruar me këto çmime, duke i bashkangjitur edhe fotografitë e stokeve të cilat OE i rekomanduar i posedon. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të OE ankues dhe përgjigjes së OE të rekomanduar për kontratë për autoritetin kontraktues, Paneli Shqyrtues vlerëson se arsyetimi i OE të rekomanduar është i pa arsyeshëm sepse rreth 80% e pozicioneve të OE të rekomanduar janë me çmime jo normalisht të ulëta dhe arsyetimi i tillë se kanë stoke të tepërta është i pa bazuar. Paneli Shqyrtues do ta merrte në konsideratë nëse OE i rekomanduar të kishte një numër të vogël të pozicioneve në stoke, por të ketë mbi 100 pozicione të ndryshme nuk është arsyetim bindës ashtu siç parashihet në rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se par. 4.2 i nenit 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, ka përcaktuar se:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Dispozita e cekur më lartë, ka përcaktuar se jo vetëm tenderi por nëse edhe një pozicion i tenderit duhet të jetë jo normalisht i ulët, AK dduhet të kërkoj nga OE një deklaram me shkrim. Në rastin konkret, AK ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar por është e pamundur që në shumicën e pozicioneve të ofroj çmime jo normalisht të ulëta dhe të zbatoj kontratën. Andaj, pretendimi i OE është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar drejt rregullat për tenderët jo normalisht sepse fotografitë nuk janë argument bindës së OE i rekomanduar

posedon stoqet për të gjitha pozicionet me të cilat ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta. AK ka mundur të kërkoj dëshmi shtesë nëse OE i rekomanduar për kontratë posedon stoqet sikurse pretendon dhe jo të bazohet në fotografi sepse fotografitë nuk shërbejnë si një dëshmi bindëse. Andaj, obligohet AK që të bëjë rivlerësimin e ofertave në harmoni me nenin 59 dhe 61 të LPP-së, si dhe të zbatoj në përpikëri rregullat për tenderët jo normalisht të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE N.T.G "Blendi"-Prishtinë;
- 1x1 OE "N.T "Agimi-De" & "Hajrije Selmanaj B.I"-Deçan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.